

TERMA REFERENCE

Zhvillues dhe editues i përmbajtjes së platformës www.vullnetarizmi.al

INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH POZICIONIT TË PUNËS

Lloji i kontratës: Ekspert me kohë të pjesëshme- Kontratë shërbimi

Kohëzgjatja e kontratës: 45.6 ditë pune (Mars 2021-Mars 2022)

Autoriteti Kontraktues: Organizata Përtej Barrierave

Baza e punës: Në distancë/online

Gjuha e kërkuar: Shqip dhe Anglisht

Afata i fundit i aplikimit: **18 Mars 2021, Ora 16:00**

Data e fillimit të kontratës: 24 Mars 2021

MBI PROJEKTIN

VullnetarizmiPikëAL është një projekt i cili ka si qëllim krijimin e një mjedisi mundësues shumë dimensional ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyc për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri.

Organizata Përtej Barrierave në bashkëpunim me Projektet Ndërkombëtare Vullnetare-PVN dhe Qendra e Progresit dhe Zhvillimit po zbatojnë projektin 15-mujor, i cili është mbështetur financiarisht nga mekanizmi i granteve strategjike të LevizAlbania, një projekt i financuar nga Qeveria Zvicerane përmes "Zyrës Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim".

Projekti përmirëson infrastrukturën egzistente ligjore dhe sociale me ndërhyrje sistemike nga poshtë-lart dhe propozon një sistem funksional me qasje inovative dhe impakt të drejtëpërdrejtë për vullnetarizëm gjithëpërfshirës, cilësor dhe me standarde për të gjithë aktorët e interesuar.

Objektivat e Projektit

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

- Të identifikojë strukturat egzistuese, nevojat dhe sfidat mbi vullnetarizmin në nivel kombëtar duke eksploruar potencialin e bashkëpunimeve ndër-sektoriale që mbështesin kërkime të reja cilësore dhe sasiore dhe të ofrojë alternativa funksionale në sektorin e vullnetarizmit.
- Të advokojë dhe llojojë në nivel institucional përmes një procesi pune gjithëpërfshirës midis shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore, për të përmirësuar kuadrin ligjor egzistues të vullnetarizmit, duke sugjeruar modele dhe qasje fleksibël.
- Të krijojë struktura të qëndrueshme ndërvepruese midis aktorëve të interesuar për bashkëpunim, partneritete dhe zhvillimin e modeleve gjithëpërfshirëse të vullnetarizmit në nivel kombëtar nëpërmjet përdorimit të burimeve dixhitale inovative.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Qëllimi i detyrës

www.vullnetarizmi.al do të jetë një platformë kombëtare dixhitale ndërvepruese për vullnetarizmin në Shqipëri, si dhe një mjet promovues, informativ dhe lehtësues dhe i organizuar të rekrutimit të vullnetarëve. Kjo platformë do të jetë gjithashtu një risi në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave cilësore dhe sasiore në këtë fushë.

Ndërkohë që platforma është në ndërtim, Organizata Përtej Barrierave po kërkon një ekspert për **Zhvillimin dhe editimin** e përmbajtjes së platformës e cila do të jetë në gjuhën Shqipe.

Ekspertiza e kërkuar

Disa nga funksionet kryesore të kësaj detyre konsistojnë në:

- Zhvillimin dhe krijimin e materialeve që promovojnë dhe nxisin e frymën e vullnetarizmit në Shqipëri;
- Përkthimi i lajmeve, përmbledhjeve dhe materialeve mbi vullnetarizmit nga gjuhë të huaja në shqip;
- Përmbledhja dhe përshtatja e lajmeve dhe botimeve para publikimit të tyre në faqen e internetit të platformës;
- Ekspozimi i praktikave të mira të vullnetarizmit në vend, përshtypje nga puna vullnetare, dhe eksperiencia ndërkombëtare me programe si European Solidarity Corps apo programe të tjera.

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

- Marrja dhe përditësimi i informacionit mbi tematikën e vullnetarizmit në vend dhe jo vetëm;
- Shfaqja dhe shpërndarja e aktiviteteve dhe advokimi mbi vullnetarizmin në vend, etj.

Kohëzgjatja e ekspertizës

Detyra	Ditët e punës	Tabela indikative	Vendi i punës
Pregatitje e materialeve dhe detyrave të lartpërmendura	45.6	22 Mars 2021 31 Mars 2022	Online

Kujt i përgjigjet

- Eksperti mban komunikim të drejtëpërdrejtë me Kordinatoren e Projektit pranë Përtej Barrierave dhe merr detyrat prej saj;
- Eksperti bashkërendon punën kur është e nevojshme dhe me 2 partnerët e projektit kur materialet e prodhura lidhen direkt me mbarëvajtjen dhe ecurinë e vetë projektit VullnetarizmiPikëAl.

AFTËSITË DHE PËRVOJA E KËRKUAR

Kualifikimi akademik

- Diplomë Universitare: shkencat shoqërore ose në fusha të tjera të ngjashme.

Eksperiencia e punës

- Përvojë dhe familjarizim me infrastrukturën e vullnetarizmit në Shqipëri;
- Eksperiencë të mëparshme në fushën e vullnetarizmit, si dhe pjesëmarrje në evente apo trajnime mbi vullnetarizmin.
- Aftësi të shkelqyera në përmbledhje dhe editim të teksteve edukative;
- Nivel i lartë i aftësive të organizimit dhe menaxhimit të kohës;

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Gjuha

- Aftësi shumë të mira në të folur dhe në të shkruar në Shqip dhe në Anglisht;

Procedura e aplikimit:

Kandidatët e interesuar dhe të kualifikuar duhet të aplikojnë duke dërguar dokumentat e mëposhme:

- Letër motivimi që shpjegon pse jeni kandidati i duhur për këtë pozitë (maksimumi 1 faqe)
- CV/Portofoli i ofruesit të shërbimit (demostrimi i punës së mëparshme në fushën përkatëse.)
- Curriculum Vitae CV

Aplikimet do të dorëzohen vetëm përmes postës elektronike.

Nëse jeni të interesuar për të aplikuar për këtë pozicion dhe ju i përmbushni të gjitha kriteret, ju lutem dërgoni aplikimin tuaj që përmban të gjitha dokumentat e nevojshme, në email, në office@beyondbarriers.org, dhe irena.topalli@beyondbarriers.org jo më vonë se **në datën 18 Mars 2021, ora 16:00**

Përzgjedhja dhe njoftimi

Aplikantët do të vlerësohen për dy aspektet si më poshtë:

- Aspektet teknike sipas procedurës së aplikimit
- Përmbushja e aftësive dhe përvojës së kërkuar

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë do të njoftohen me email brenda datës **22 Mars 2021**.

Kontaktet:

Irena Topalli – Kordinatore e projektit - E-mail: irena.topalli@beyondbarriers.org

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC